

**VENDIM**  
**Nr. 667, datë 10.11.2021**

**PËR TRAJTIMIN E VULLNETARËVE PËR ANGAZHIMIN E TYRE NË  
AKTIVITETE TË MBROJTJES CIVILE APO NË OPERACIONET E  
PARANDALIMIT E TË PËRBALLIMIT TË FATKEQËSIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 38, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Trajtimin e vullnetarëve, për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, për:

a) transportin:

i. në rast se vullnetari do të angazhohet në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive jashtë territorit të vendbanimit të tij të zakonshëm;

ii. kur transporti nuk realizohet nga vetë institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ofrohen vullnetarët, shpenzimet e transportit do të njihen kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për tarifat e transportit të udhëtarëve;

b) trajnimin, në rastet kur kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

c) ushqimin, sipas mënyrës së paracaktuar nga institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ofrohen vullnetarët, në varësi të situatës së krijuar, por jo më shumë se vlera prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekësh në ditë;

ç) mjetet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, të cilat do t’i jepen vullnetarit në përdorim nga institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ato ofrohen;

d) akomodimin, i cili, në varësi të aktiviteteve të mbrojtjes civile apo operacioneve të parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, do të kryhet:

i. në formën e kompensimit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, të paraqitur nga hoteli dhe të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë për çdo natë;

ii. në tenda/çadra apo struktura të tjera të përshtatura për akomodim.

2. Sigurimi i jetës dhe i shëndetit, për vullnetarët që angazhohen në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik nga institucioni apo struktura qendrore dhe vendore e mbrojtjes civile, përgjegjëse për parandalimin e përballimin e fatkeqësisë, sipas natyrës së saj. Ky sigurim mbulon shpenzimet për trajtimin e dëmtimeve që vijnë si rezultat i angazhimit në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, si më poshtë vijon:

a) vdekje si rezultat i dëmtimeve;

b) paaftësi e përhershme ose aftësi e kufizuar, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit;

c) paaftësi e përkohshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit dhe për shkak të tij;

ç) paaftësi e përkohshme, si rezultat i një sëmundjeje të pësuar gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit dhe për shkak të saj;

d) shërbime spitalore dhe/ose mjekësore në spitalet publike ose private brenda shtetit, kur mbulimet shëndetësore nuk ofrohen në spitalet publike të vendit.

3. Shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit për çdo punonjës të siguruar nuk mund të jetë më e ulët se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

4. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit, por nuk mund të jetë më e ulët se 0.5 (zero pikë pesë) %.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i miratuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

6. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ofrohen vullnetarët, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**